

VENDIM
Nr. 258, datë 7.5.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 331, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I LINJËS 110 kV LUSHNJË–FIER’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 331, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Lushnjë–Fier’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 199 890.48 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e tetë) lekësh.”;

b) Në pikën 4, togfjalëshi “... prej 363 875 (treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh” zëvendësohet me “... prej 2 199 890.48 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e tetë) lekësh.”.

2. Tabelës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 331, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, i shtohet pasuria me numër rendor “68” dhe të dhënat sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë dhe Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV LUSHNJË–FIER”

Nr. rendor	Nr. shtyllë	Pronari			Të dhëna hipotekore							Vlerësimet për shpronësim						Shënime				Adresa	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Arë			Ndërtesë			Vlera totale (lekë)	Nr. dok.	Data e regjistrimit		Seksionet D & E të kartelës së pasurisë
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)					
		A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V
68	Midis shtyllës 74–75	Veli	Gjysho	Muçaj	Portëz, Fier	3031	285/1	Arë + Truall	6,782		4,014	1,624				180.20		1,836,015.48	1,836,015.48			Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati: Portëz, NJ. A.: Portëz , Bashkia Fier.
		Islam	Gjysh	Muçaj																			
		Bardhosh	Gjysho	Muçaj																			
		Myserete	Muharem	Muçaj																			
		Floresha	Haxhi	Muçaj																			
		Shqiponja	Myrto	Muçaj																			
SHUMA TOTALE																			1,836,015.48				